

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

URDHËR

NR 53 DATE 10 . 10 . 1997

PËR PJESËMARRJEN E PROKURORIT NE NGJARJET E RENDA
KRIMINALE

Unë Arben Rakipi, Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, duke çmuar tepër të rëndësishme veprimet e para hetimore në ngjarjet e renda kriminale dhe qëllim përmirësimit të dukshëm të hetimeve paraprake, vlerësoj shumë të nevojshme pjesëmarrjen e kualifikuar të prokurorit në këto ngjarje.

Për këtë qëllim, konform nenit 24/4 të Kodit të Procedurës Penale:

URDHËROJ:

I. Të marrë pjesë prokurori direkt në këqyrjen e vendit të ngjarjes, marrjen e deklarimeve të para nga dëshmitarë okulare, ose në veprime të tjera hetimore që kryhen ditën e ngjarjes, ose pas saj, në krimet me pasoja të renda dhe konkretisht:

1. Në krimet kundër jetës të kryera me dashje (vrasjet), të parashikuara nga nenet 76, 77, 78, 79, 82 dhe 83 të Kodit Penal.
2. Në veprat tjera të kryera me dashje kundër shëndetit në flagrance, dhe konkretisht në torturat të parashikuara nga nenet 86 e 87 të Kodit Penal.
3. Në krimet seksuale, kur ato janë denoncuar në flagrance, pas ndodhjes se

tyre, ose kane ardhur pasoja te renda te parashikuara nga nenet 100, 101, 102/2, 3, 103 dhe 104 te Kodit Penal.

4. Ne veprat penale kundër lirisë se personit te denoncuar ne flagrante, dhe konkretisht ne rrëmbimet e personit te parashikuar nga neni 109/1, 2 te Kodit Penal.
5. Ne veprat penale kundër pasurisë, dhe konkretisht Ne vjedhjet, te parashikuara nga nenet 136, 140, dhe 141 te Kodit Penal.
Ne shkatërrimet e pronës kur kane ardhur pasoja te renda për jetën dhe shëndetin e njerëzve, te parashikuara nga nenet 151/3, 152/3, 153/3, 154/3.
6. Ne veprat penale kundër mjedisit, dhe konkretisht transportimi i mbeturinave toksike, kur kane ardhur pasoja te re për jetën e shëndetin e njerëzve, te parashikuar nga neni 202/2 i Kodit Penal.
7. Ne krime kundër Rendit Kushtetues, Atentati dhe kryengritja, te parashikuara respektivisht nga nenet 219 dhe 220 te Kodit penal.
8. Ne krimet qe cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, ato te parashikuara nga nenet 226 dhe 228/2 te Kodit Penal.
9. Ne aktet terroriste, krime këto te parashikuara nga nenet 230, 231, 232, 233, dhe 234 te Kodit Penal.
10. Ne veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, dhe konkretisht prodhimi dhe shitja e narkotikeve, prodhimi dhe shitja e ushqimeve dhe e lendeve te tjera te rrezikshme për shëndetin, si dhe shkelja e

rregullave te mbrojtjes ne pune, te parashikuara respektivisht nga nenet 283, 288 dhe 289 te Kodit Penal.

II. Ky urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHEM

ARBEN RAKIPI



